



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL. Anr.218/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të përdorimit të të miturve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa ZL.Anr.218/2017 e datës 13.10.2017, e parashtruar nga BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me datën 13.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për Kuvendin Komunal të Prizrenit, Nehat Elshani nga radhët e subjektit politik PDK pretendohet se ka shkelur Rregullën Nr. 13/2013, Neni 5.2. pasi që në spotin e tij të publikuar në rrjetin social facebook ka përdorur pamje të fëmijës nën moshën 14 vjeç. Me këtë veprim konsiderojnë se kandidati për Kuvendin Komunal ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD dhe fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 14.10.2017, subjekti politik PDK, thekson se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë krejtësisht të pabazuara dhe se nuk përmbajnë shkelje ligjore. Më tej kanë shtuar se video e prezentuar si spot i kandidatit Nehat Elshani në asnjë sekuenç të tijë nuk përmban shkelje të rregullës 13/2013 nenit 5 pika 2 sepse ai në këtë rast bënë prezantimin e tij dhe të aktivitetëve jetësore duke treguar se është familjarë së bashku me fëmijën dhe bashkëshorten, dhe se prezantimi i familjes nuk përmban asnjë shkelje ligjore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe provave të bashkangjitura, erdhi në përfundim se pretendimet në ankesë janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi për faktin se nga video që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se ka elemente të fushatës zgjedhore me fëmijë pasi që në spotë shihen bashkëshortja dhe fëmija e kandidatit për kryetar të Komunës së Prizrenit, Nehat Elshani nga radhët e subjektit politik PDK. Fëmija në këtë spot nuk shihet se është duke promovuar ndonjë llojë të materialit zgjedhorë të subjektit në fjalë andaj për rrjedhojë rezulton se në këtë rast nuk ka elemente të fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur ashtu si pa bazë theksohet në ankesë.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.218/2017 me datë 16.10.2017.



Kryesues i Panelit

Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.